



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 357, datë 26.5.2022

P Ë R

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË RREGULLAVE
TË TRANSFERIMIT TË TË DREJTAVE MINERARE
NGA ZOTËRUESI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. KRITETET PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE MINERARE

1. Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, janë të transferueshme pas një periudhe 5-vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare.
2. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, "Ligji mineral i Shqipërisë", të ndryshuar, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.
3. Kriteret, që duhet të përmbushin personat juridikë, të cilëve do t'u transferohet leja minerare, janë:

a) Ligjore:

- Të jetë një person juridik, vendas ose i huaj, i regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- ii. Të pranojë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet;
 - iii. Të dyja subjektet, zotëruesi i lejes minerare dhe përfituesi i saj, të pranojnë sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim se ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore të veprimtarisë minerare, vlerësohen veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të.

b) Financiare:

Të kenë aftësi financiare për vazhdimin e realizimit të investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare, në përputhje me parashikimet e nënndarjes "i", të shkronjës "dh", të pikës 6, të këtij kreu.

c) Teknike dhe profesionale:

Të kenë aftësi teknike dhe profesionale për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare dhe projektit të rehabilitimit të mjedisit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "e", "f", "g" e të pikës 6, të këtij kreu.

4. Zotëruesi i lejes minerare paraqet në Qendrën Kombëtare të Biznes (QKB) dokumentacionin e plotë për transferimin e lejes minerare. QKB-ja pas verifikimit të dokumentacionit e përcjell atë pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare.
5. Dokumentet për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të transferimit, që duhet të plotësojnë kërkuuesit për transferimin e një lejeje minerare, janë, si më poshtë vijon:
 - a) Kërkesa në QKB për transferimin e lejes minerare nga zotëruesi i lejes minerare, ku të jetë përcaktuar arsyeja/arsyet e transferimit;
 - b) Vendimi i asamblesë së ortakëve/asamblesë së përgjithshme të shoqërisë zotëruese të lejes minerare për transferimin e lejes minerare;
 - c) Vendimi për marrjen e lejes i asamblesë së ortakëve/asamblesë së përgjithshme të shoqërisë që kërkon t'i transferohet leja minerare;
 - ç) Aktmarrëveshja e nënshkruar përpara noterit, ndërmjet dy shoqërive për transferimin e lejes minerare, ku të jetë përcaktuar që subjekti, i cili kërkon t'i transferohet leja minerare, pranon së bashku me transferimin e lejes

minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet, si dhe detyrimet, sipas përcaktimeve të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

6. Dokumentet e subjektit, që kërkon t’i transferohet leja minerare, janë, si më poshtë vijon:

- a) Vërtetimi se subjekti ka statusin aktiv;
- b) Vërtetimi se subjekti nuk është i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë dhe nuk është në ndjekje penale;
- c) Ekstrakti nga QKB-ja për regjistrimin si person juridik, në objektin e të cilit të jetë përfshirë edhe zhvillimi i veprimtarisë minerare;
- ç) Vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe ka plotësuar detyrimet fiskale;
- d) Vërtetimi se subjekti ka paguar detyrimet për energjinë elektrike, të lëshuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
- dh) Konfirmimi për burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare, të vërtetuara nga dokumentet e mëposhtme:
 - i. Kopja e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit, e certifikuar nga administrata tatimore;
 - ii. Vërtetimi nga banka që konfirmon se personi juridik ka të depozituara në numrin e llogarisë të paktën 20% të vlerës së investimit të parashikuar për t’u realizuar në programin e investimeve. Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të dokumenteve;
 - iii. Në rastet kur shoqëria ka paraqitur një dokument noterial me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit, ky dokument duhet të shoqërohet me dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit, të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “dh”, të kësaj pike.
- e) Vërtetime mbi përvojën në fushën minerare apo referenca për përmbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngjashme, të lëshuara nga një ent publik ose privat, që tregon vlerën, kohën dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni minerar në fuqi. Në rast se subjekti nuk ka përvojë në fushën minerare, atëherë ai duhet të paraqesë një dokument noterial (marrëveshje bashkëpunimi) në të cilin shprehet vullneti për mbështetje teknike nga një subjekt me përvojë në fushën minerare. Subjekti mbështetës duhet të

vërtetojë eksperiencën e tij në fushën minerare me dokumentacionin e parashikuar në këtë vendim.

- ë) Historiku i aktivitetit të shoqërisë;
- f) Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit, si *Curriculum Vitae*, diploma, leje profesionale apo dokumente të tjera të ngjashme;
- g) Certifikata profesionale e drejtuesit teknik dhe kontrata me drejtuesin teknik;
- gj) Vetëdeklarimi mbi punonjësit dhe stafin drejtues të shoqërisë;
- h) Lista e mjeteve, e shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë të drejtat reale që subjekti gëzon ndaj tyre (pronësi, qira, përdorim apo çdolloj tjetër posedimi).

7. Dokumentet e zotëruesit të lejes minerare janë, si më poshtë vijon:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe ka plotësuar detyrimet fiskale;
- b) Miratimi nga strukturat përgjegjëse për kapacitetet e prodhimit vjetor, vlerën e investimeve, vlerat e garancive, të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

II. RREGULLAT PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE MINERARE NGA ZOTËRUESI

1. Vlerësimi i kushteve të transferimit dhe dokumentet vërtetuese për kërkesat për transferimin e një lejeje minerare realizohen nga drejtoria përkatëse në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, në bazë të dokumentacionit të përcjellë nga QKB-ja. Kjo drejtori harton aktin e transferimit ose refuzimit të lejes minerare, që miratohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.
2. Ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare, brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit, nënshkruan aktin e miratimit ose refuzimit të transferimit të lejes minerare, të cilin e dërgon në QKB. Në rastin e refuzimit, subjektet e interesuara kanë të drejtën e ankimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
3. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e

transferimit është data e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve. Akti i transferimit regjistrohet edhe në regjistrin minerar nga strukturat përgjegjëse.

4. Të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në transferimin e lejes minerare informohen për miratimin ose jo të kërkesës nga QKB-ja brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i aktit të transferimit.

IV. TË FUNDIT

1. Vendimi nr.362, datë 29.4.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare", shfuqizohet.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELENA BALLUKU